



Posta e Kosovës Sh. A.

FILATELIA E POSTËS SË KOSOVËS

SHPALL KONKURS

**Për dizajne artistike të motiveve për pulla postare dhe blloqe filatelike për programin e rregullt të pullave postare për vitin 2024**

Në kuadër të programit vjetor 2024 të pullave postare, do të përzgjidhen dizajnet më të bukura për emisionet si më poshtë:

1. Tematika e emisionit: **“Kampionati Evropian i Futbollit 2024”**.  
Përshkrimi: Paraqitja artistike në pikturë, fotografi artistike, grafikë, etj.  
Shpërblimi: Vendi i parë €300; vendi i dytë €250; blloku filatelik €350.
2. Tematika e emisionit: **“Lojërat Olimpike Verore ‘Paris 2024”**.  
Përshkrimi: Paraqitja artistike e Lojërave Olimpike në vizatim, grafikë, apo foto artistike.  
Shpërblimi: Vendi i parë €300; vendi i dytë €250; blloku filatelik €350.
3. Tematika e emisionit: **“Pyjet dhe rudinat”**.  
Përshkrimi: Paraqitja artistike në pikturë, vizatim, fotografi artistike, grafikë, etj.  
Shpërblimi: Vendi i parë €300; vendi i dytë €250; blloku filatelik €350.
4. Tematika e emisionit: **“Antropomorfet”**.  
Përshkrimi: Paraqitja artistike në pikturë, fotografi artistike, grafikë, etj.  
Shpërblimi: Vendi i parë €300, vendi i dytë €250, vendi i tretë €200.
5. Tematika e emisionit: **“Cjapi i bronzë”**.  
Përshkrimi: Paraqitja artistike në vizatim, pikturë, fotografi, grafikë, etj.  
Shpërblimi: Një pamje për pullë postare: € 300.

6. Tematika e emisionit: **“Kalaja e Prizrenit”**.  
Përshkrimi: Paraqitja artistike e Kalasë së Prizrenit.  
Shpërblimi: Vendi i parë €300, vendi i dytë €250.
  
7. Tematika e emisionit: **“Evropa 2024 - flora dhe fauna nënujore”**.  
Përshkrimi: Paraqitja artistike e florës dhe faunës në vizatim, pikturë, fotografi, grafikë.  
Shpërblimi: Vendi i parë €300, vendi i dytë €250, blloku filatelik €350.
  
8. Tematika e emisionit: **“Qytetet-Istogu”**.  
Përshkrimi: Paraqitja artistike e qytetit në vizatim, grafikë, fotografi artistike, pikturë, etj.  
Shpërblimi: Vendi i parë €300, vendi i dytë €250.
  
9. Tematika e emisionit: **“Objekte fetare - Xhamia e Sinan Pashës, Manastiri i Graçanicës”**.  
Përshkrimi: Paraqitja artistike e enterierit dhe eksterierit në pikturë, vizatim, grafikë, fotografi artistike, etj.  
Shpërblimi: Vendi i parë €300, vendi i dytë €250.
  
10. Tematika e emisionit: **“Mbrojtja e ambientit”**.  
Përshkrimi: Paraqitja artistike e mbrojtjes së ambientit në vizatim, grafikë, fotografi artistike, etj.  
Shpërblimi: Vendi i parë €300, vendi i dytë €250, vendi i tretë €200.
  
11. Tematika e emisionit: **“Pop Rock-u kosovar i viteve të 80-ta”**.  
Përshkrimi: Paraqitja artistike në pikturë, vizatim, grafikë, fotografi artistike, etj.  
Shpërblimi: Vendi i parë €300, vendi i dytë €250.
  
12. Tematika e emisionit: **“Flora endemike”**.  
Përshkrimi: Paraqitja artistike në: pikturë, vizatim, grafikë, fotografi artistike, etj.  
Shpërblimi: Vendi i parë €300, vendi i dytë €250, vendi i tretë €200, vendi i katërt €150.
  
13. Tematika e emisionit: **“Fauna endemike”**.  
Përshkrimi: Paraqitja artistike në pikturë, vizatim, grafikë, fotografi artistike, etj.  
Shpërblimi: Një pamje për pullë postare €300.

#### 14. Tematika e emisionit: **“Monumentet natyrore/Trungjet e mbrojtura”**.

Përshkrimi: Paraqitja artistike e trungjeve të mbrojtura në Kosovë në pikturë, vizatim, grafikë, fotografi artistike, etj.

Shpërblimi: Vendi i parë €300, vendi i dytë €250, vendi i tretë €200.

#### **RREGULLAT E KONKURRIMIT:**

1. Dizajnet artistike të bazuara në këto tema duhet të punohen në programe të specializuara për dizajn (Adobe Photoshop, Illustrator, Corel Draw, apo pamje nga piktura, fotografi, vizatime personale etj, të përpunuara grafikisht); të njëjtat duhet të dorëzohen të shtypura dhe në fajll kompjuterik.  
Punimet me rezolucion më të ultë se **500 px**. (TIFF, JPG ose PDF) nuk pranohen.
2. Emri i autorit të dizajnit nuk duhet të shënohet pranë motivit konkurrues, aty duhet të duket vetëm shifra.
3. Dizajnet konkurruese për këtë konkurs duhet të dorëzohen në zarfe të mbyllura.
4. Një autor mund të konkurrojë me numër të pacaktuar të punimeve, mirëpo me shifra të ndryshme për secilin emision.
5. Punimet e printuara konkurruese me CD vendosen në zarf, i cili duhet të përmbajë edhe zarfin e mbyllur me shënimet personale të autorit.
6. Punimet konkurruese për emisione të ndryshme duhet paketuar veçmas, duke e shënuar mbi zarf titullin e emisionit për të cilin konkurrenca dhe shifrën.
7. Përgjegjësinë mbi të drejtat autoriale e mban autori i dizajnit (konkurruesi).
8. Bazuar në: **LIGJIN Nr. 04/L-065 PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA**, autori fitues i dizajneve të huazuara duhet patjetër të posedojë autorizimin me shkrim ose me e-mail nga autori i veprës origjinale, të cilën mund t’ia bashkëngjitë punimeve konkurruese ose ta dërgojë të skanuar në e-mail adresën: [filatelia@postakosoves.com](mailto:filatelia@postakosoves.com) dhe ta sjellë në “hard copy” në zyrën e Filatelisë.

Për shkaqe të konfidencialitetit dhe për shkak të objektivitetit, në pjesën e jashtme të zarfeve dhe në CD duhet të shënohet vetëm shifra e zgjedhur nga vet autori (askund në punime nuk duhet të duket emri apo mbiemri i autorit, vetëm shifra).

Komisioni i Pullës Postare, gjatë përzgjedhjes së dizajnëve, nuk do të ketë qasje në shënime autoriale, por ka të drejtë të verifikojë mbi origjinalitetin e dizajnëve të përzgjedhur.

**KONKURSI do të jetë i hapur 40 ditë kalendarike, prej datës: 18.09.2023 deri më 27.10.2023** dhe do të jetë i publikuar në ueb faqen: [www.postakosoves.com](http://www.postakosoves.com).

Punimet konkurruese nuk do t’iu kthehen autorëve.

**Zgjedhjen e punimeve më të mira konkurruese, duke u bazuar në dizajnin më të mirë dhe ndarjen e shpërblimeve, do ta bëjë Komisioni i Pullës Postare.**

Punimet duhet dorëzuar, apo dërguar në këtë adresë:

**FILATELIA**

**Për Konkurs-Filateli**

**Ndërtesa e Postës së Kosovës p.n.**

**Fushë Kosovë 12000**

**Republika e Kosovës**

Për informata shtesë mund të thërrisni në numrin e telefonit: **+383(0)38 246 770**, apo të drejtoheni në e-mail adresën: [filatelia@postakosoves.com](mailto:filatelia@postakosoves.com), ose në ueb faqen zyrtare: [www.postakosoves.com](http://www.postakosoves.com).